

VENDIM
Nr. 82, datë 31.5.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DIEZELA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LJUSA”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 8, pika 8; nenit 10 pikat 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Diezela” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Diezela” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria “Diezela” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 316 prot., datë 26.4.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Diezela” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3; pika 4.1.4, gjerat “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar.

- Shoqëria “Diezela” sh.p.k., në cilësinë e mbajtësit të miratimit përfundimtar me nr. 2413/6, datë 15.12.2017 dhe në zbatim të VKM-së nr. 822 datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, ka lidhur me MIE kontratën me nr. 15 rep. dhe nr. 8 kol., datë 10.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kw, në Përroin e Zallit të Madh, degë e përroit të Lusës, kjo e fundit degë fundore e krahut të djathtë të lumit Mat, Bashkia Mat, qarku Dibër”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën e qirasë nr. 1460 prot., datë 5.6.2018, “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullosor publik shoqërisë “Diezela” sh.p.k., për ndërtimin e HEC “LJUSA”, të lidhur midis Bashkisë Mat dhe shoqërisë “Diezela” sh.p.k. Objekti i kësaj kontrate konsiston në dhënien me qira të fondit pyjor – kullosor për ndërtimin e HEC “Ljusa”. Nga kjo kontratë rezulton se mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral sipërfaqja e kërkuar është 2.507 ha dhe shtrihet në ngastrën: 178;173 të Ekonomisë Pyjore Derjan 1 dhe ngastrat 45 të ekonomisë pyjore Balgjaj, si dhe do të merret në përdorim sipërfaqja prej 2.507 ha në pronësi të Bashkisë Mat. Kjo kontratë mban një afat një vjeçar që fillon nga e nesërmyja e datës së nënshkrimit të saj. Referuar datës së nënshkrimit, afati i kësaj kontrate përfundon në datë 5.6.2019.

- “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE mund

të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

Në pikën 4, të nenit 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se: *Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera.*

Afati i “Kontratës së qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullësor publik shoqërisë “Diezela” sh.p.k. për ndërtimin e HEC “LJUSA”, të lidhur midis Bashkisë Mat dhe shoqërisë “Diezela” sh.p.k.”, përfundon në datën 5.6.2019. Si e tillë do t’i kërkohej shoqërisë të paraqesë në ERE brenda afatit të mbylljes së procedurave të licencimit, kontratën e rinovuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

- Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna teknike për HEC do t’i kërkohej shoqërisë të sjellë në ERE të plotësuar edhe të dhënat për tensionin e rrjetit të shpërndarjes; vitin e ndërtimit; datën e fillimit të operimit dhe jetëgjatësinë e pritshme të centralit). Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, do t’i kërkohej shoqërisë të paraqesë në ERE të plotësimet përkatëse për të dhënat që mungojnë që kanë të bëjnë me Prodhuesin e transformatorit dhe skemën e lidhjes së përcjellësve). Neni 9, pika 4.1.4, germa “a” (dokumentacioni tekniko-ekonomik, studimi i fizibilitetit, do të saktësohet me subjektin nëse ka të hartuar një studim fizibiliteti në një dokument të veçantë), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti